




Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac – Municipality of Rahovec

KRYETARI I KOMUNËS
Presednik Opštine – Municipal Mayor


**LISTA E VENDIMEVE TË MARRA NGA KRYETARI I KOMUNËS SË RAHOVECIT,
Z. SMAJL LATIFI**

NGA DATA 14.04.2026 DERI MË 17.04.2026

NR.	EMRI I VENDIMIT	NR. I PROTOKOLLIT
1.	Vendim për emërimin e personit përgjegjës për hartimin e specifikimeve teknike/termave të referencës për aktivitetin e prokurimit : “Hartimi i projekteve të ndryshme”	NRP-02-7210-2026
2.	Vendim për formimin e komisionit për ndërrim të kulturës bujqësore nga kultura “mal” i klasës në kulturë “arë” në parcelën P-7150005-00004-0.	NRP-02-7212-2026
3.	Vendim për formimin e komisionit për vlerësimin e ofertave për projektin: “Furnizimi me oksigjen dhe me boca të oksigjenit	NRP-02-7213-2026
4.	Vendim për emërimin e personit përgjegjës për hartimin e specifikimeve teknike/termave të referencës për aktivitetin e prokurimit : “Ndërtimi i serrave për fermerë me participim 80% - 20%”	NRP-02-7215-2026
5.	Vendim për caktimin e grupit punues për hartimin e projektbuxhetit të Komunës së Rahovecit për vitin 2026-2029.	NRP-02-7216-2026
6.	Vendim për autorizimin e zyrtarëve të Komunës së Rahovecit që të punojnë jashtë orarit të punës	NRP-02-7217-2026
7.	Vendim për nënshkrimin e të gjitha kontratave të punës të personelit shëndetësorëe”	NRP-02-7218-2026



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac / Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008”), nenit 28 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 18/2011”), nenit 19 paragrafi 19.16 i Rregullores Nr. 002/2024 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr. 1005, i datës 29.3.2017, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për emërimin e personit përgjegjës për hartimin e specifikimeve teknike / termave të referencës për aktivitetin e prokurimit: “Hartimi i Projekteve të ndryshme”

1. Sokol Thaqi dhe Jetmir Ukaj, **emërohen** persona përgjegjës për hartimin e specifikimeve teknike / termave të referencës për aktivitetin e prokurimit: “Hartimi i projekteve të ndryshme”.
2. Personat përgjegjës, sipas pikës 1 të këtij vendimi, ka për detyrë që të bëjë hartimin e specifikimeve teknike / termave të referencës, duke u bazuar në Ligjin Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, Rregulloren Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik dhe Rregulloren Nr. 002/2024 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.
3. Përgjegjësitë e personave për hartimin e specifikimeve teknike / termave të referencës, janë:
 - 3.1. Në përputhje me qëllimin e prokurimit dhe të drejtuara drejt sigurimit të qasjes sa më të mirë për të gjithë operatorët e interesuar ekonomikë, në përputhje me nenin 28 Ligji nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe i plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 dhe akteve nënligjore (legjislacionit dytësor);
 - 3.2. Në atë mënyrë që nuk favorizojnë ose diskriminojnë një ose më shumë operatorë ekonomikë;
 - 3.3. Të cilat nuk i referohen një artikulli ose burimi të veçantë, një procesi të hollësishëm, ndonjë shenje dalluese, lloji ose origjine të veçantë, ose ndonjë prodhimi.
4. Personat përgjegjës obligohen që të hartojnë specifikimet teknike / termat e referencës deri më datë 21.04.2026.

5. Personat përgjegjës obligohen që, së bashku me specifikimet teknike / termat e referencës, të dorëzojnë edhe deklaratën në betim, të nënshkruar te Njësia e Prokurimit.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Me vendim të njoftohen:

- *Sokol Thaqi,*
- *Jetmir Ukaj*
- *Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit,*
- *Njësia e Prokurimit, dhe*
- *Arkivi.*

Smajl Latifi
Kryetar i Komunës





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac / Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA RAHOVEC / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TE KOMUNES / KABINET PREDSEDIKA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 7212 Nr. i faq./Br.str/No.pg 24
Data/Datum/Date 15/04/26
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), , nenit 63 dhe 92 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr.1005, i datës 29.3.2017 dhe duke shqyrtuar kërkesën e Këshillit të Bashkësisë Islame në Rahovec, me nr.1377/2026, të datës 1.4.2026, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

1. Formohet Komisioni për ndërrim të kulturës bujqësore nga kultura “mal i klasës II, në kulturë “arë”, në parcelën P – 71510005-00004 -0, zk Brestoc, me sipërfaqe 15046 m², në përbërje prej:
 - 1.1. Ilvi Durguti, kryesues,
 - 1.2. Elma Shehu, anëtare,
 - 1.3. Biondina Ramaj, anëtare.
2. Komisioni ka për detyrë që të bëjë vlerësimin dhe t’i ndërmarrë të gjitha veprimet e domosdoshme për ndërrim të kulturës bujqësore nga kultura “mal i klasës II”, në kulturë “arë”, në parcelën P – 71510005-00004 -0, zk Brestoc, me sipërfaqe 15046 m².
3. Obligohet komisioni që këto punë t’i kryejë duke u bazuar në legjislacionin aktual në fuqi.
4. Obligohet komisioni që pas përfundimit të punëve të hartojë raport me shkrim për Kryetarin e Komunës dhe për Drejtorinë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural në Komunën e Rahovecit.
5. Komisioni do të fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojnë në një afat të arsyeshëm.
6. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

U dërgohet:

1. Anëtarëve të komisionit,
2. Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, dhe
3. Arkivit.

Smajl Latifi

Kryetar i Komunës





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac / Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – **Municipal Mayor**



REPUBLICA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC

KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS / KABINET PRESEDIKA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 7213 Nr. i faq./Br.str./No.pg 24
Data/Datum/Date 15 / 04 / 26
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 59 të Ligjit Nr.04/L-042 të prokurimit publik, nenit 37 i Ligjit Nr.05/L-068, për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për prokurimin publik, nenit 63 dhe 92 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr.1005, i datës 29.3.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

1. Formohet komisioni për vlerësimin e ofertave për projektin “**Furnizimi me oksigjen dhe me boca të oksigjenit**”, me nr. prokurimi: **623-26-2059-1-3-6**, me numër të brendshëm: **623-26-007-1-3-6**, të datës 14.4.2026, në përbërje prej:
 - 1.1. Egzon Thaqi, kryesues,
 - 1.2. Vjollca Berisha, anëtare,
 - 1.3. Veton Kabashi, anëtar.
2. Komisioni ka për detyrë që të bëjë vlerësimin dhe krahasimin e ofertave të tenderit për projektin “**Furnizimi me oksigjen dhe me boca të oksigjenit**”.
3. Obligohet komisioni që këto punë t’i kryejë duke u bazuar në legjislacionin aktual në fuqi.
4. Komisioni do të fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojnë në një afat të arsyeshëm.
5. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

U dërgohet:

1. Anëtarëve të komisionit
2. Zyrës së Prokurimit, dhe
3. Arkivit.

Smajl Latifi

Kryetar i Komunës





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac / Municipality Orahovac
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – **Municipal Mayor**



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/РЕПУБЛИКА КОСОВО
KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Br./No 7215 Nr. i faq/Br.str/No.pg 24

Data/Datum/Date 15 / 04 / 26

RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008”), nenit 28 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 18/2011”), nenit 19 paragrafi 19.16 i Rregullores Nr. 002/2024 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr. 1005, i datës 29.3.2017, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për emërimin e personit përgjegjës për hartimin e specifikimeve teknike / termave të referencës për aktivitetin e prokurimit: “Ndërtimi i serrave për fermerë me participim 80% - 20%”

1. Blerim Sokoli, **emërohet** person përgjegjës për hartimin e specifikimeve teknike / termave të referencës për aktivitetin e prokurimit: “Hartimi i projekteve të ndryshme”.
2. Personi përgjegjës, sipas pikës 1 të këtij vendimi, ka për detyrë që të bëjë hartimin e specifikimeve teknike / termave të referencës, duke u bazuar në Ligjin Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, Rregulloren Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik dhe Rregulloren Nr. 002/2024 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.
3. Përgjegjësitë e personave për hartimin e specifikimeve teknike / termave të referencës, janë:
 - 3.1. Në përputhje me qëllimin e prokurimit dhe të drejtuara drejt sigurimit të qasjes sa më të mirë për të gjithë operatorët e interesuar ekonomikë, në përputhje me nenin 28 Ligji nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe i plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 dhe akteve nënligjore (legjislacionit dytësor);
 - 3.2. Në atë mënyrë që nuk favorizojnë ose diskriminojnë një ose më shumë operatorë ekonomikë;
 - 3.3. Të cilat nuk i referohen një artikulli ose burimi të veçantë, një procesi të hollësishëm, ndonjë shenje dalluese, lloji ose origjine të veçantë, ose ndonjë prodhimi.
4. Personi përgjegjës obligohet që të hartojë specifikimet teknike / termat e referencës deri më datë 22.4.2026.

5. Personi përgjegjës obligohet që, së bashku me specifikimet teknike / termat e referencës, të dorëzojë edhe deklaratën në betim, të nënshkruar te Njësia e Prokurimit.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.


Me vendim të njoftohen:

- ***Blerim Sokoli,***
- ***Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural,***
- ***Njësia e Prokurimit, dhe***
- ***Arkivi.***





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040 ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), nenit 53 paragrafi 3 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative nr. 05/L-031, Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr. 04/2023 për Administratë të Hapur në Komunë, nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr. 1005, i datës 29.3.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

VENDIM

Për caktimin e grupit punues për hartimin e projektbuxhetit të Komunës së Rahovecit për vitin 2027 - 2029

1. Caktohet grupi punues për hartimin e projektbuxhetit të Komunës së Rahovecit për vitin 2027 – 2029, në këtë përbërje:
 - 1.1. Ekrem Bytyqi, kryesues,
 - 1.2. Skender Hamza, anëtar, procesmbajtës,
 - 1.3. Bekim Krasniqi, anëtar, procesmbajtës,
 - 1.4. Egzon Thaqi, anëtar, procesmbajtës,
 - 1.5. Izet Morina, anëtar, përgatitje të materialeve,
 - 1.6. Alban Gashi, anëtar, lista të nënshkrimeve,
 - 1.7. Blerta Gashi, anëtare, moderatore,
 - 1.8. Albion Krasniqi, anëtar, procesmbajtës,
 - 1.9. Ardian Rama, anëtar, moderator,
 - 1.10. Senad Mullaavda, anëtar, lista të nënshkrimeve,
 - 1.11. Dhurata Rrustemi, anëtare, lista të nënshkrimeve,
 - 1.12. Ardit Halilaj, anëtar, fotograf,
 - 1.13. Almedina Jaha, anëtare, fotografe,
 - 1.14. Agnesa Ramadani, anëtare, përgatitje të materialeve,
 - 1.15. Zyber Thaqi, anëtar, procesmbajtës.
2. Grupi punues ka për detyrë që të hartojë projektbuxhetin e Komunës së Rahovecit për vitin 2027 – 2029; të bëjë hartimin e planit të brendshëm komunal për mbarëvajtjen e dëgjimeve buxhetore; ta bëjë përgatitjen e njoftimit për mbajtjen e dëgjimeve buxhetore; të caktojë personin përgjegjës për mbajtjen e procesverbalit gjatë mbajtjes së dëgjimeve buxhetore dhe ta bëjë hartimin e tij në afatin ligjor, që parashihen në Udhëzimin Administrativ (MAPL) nr. 04/2023 për Administratë të Hapur në Komunë; të bëjë raportin nga dëgjimet buxhetore dhe ta përgatisë për ta dërguar në Kuvendin Komunal.
3. Obligohet grupi punues që të veprojë duke u bazuar në ligjet dhe aktet nënligjore të aplikueshme në Republikën e Kosovës.
4. Obligohet grupi punues që, pas përfundimit të punëve, të hartojë raport me shkrim për Kryetarin e Komunës dhe për Drejtorinë për Buxhet dhe Financa.

5. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen anëtarët e grupit punues dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

6. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Me vendim të njoftohen:

- *Anëtarët e grupit punues,*
- *Drejtoria për Buxhet dhe Financa, dhe*
- *Arkivi.*


Smajl Latifi

Kryetar i Komunës





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040 ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), nenit 36 të Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat e Sektorit Publik (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 1/2023), nenit 7 paragrafi 2 dhe paragrafi 4 I Rregullores (QRK) Nr. 07/2023 për kompensimin për kujdestari, punën gjatë natës dhe punën jashtë orarit të punës, nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr. 1005, i datës 29.3.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

VENDIM

- Me këtë vendim **Autorizohen** zyrtarët e Komunës së Rahovecit, që të punojnë jashtë orarit të rregullt të punës nga data 1.10.2025 deri më datë 31.12.2025, si në vijim:
 - Lulëzim Krasniqi - Udhëheqës i Sektorit të Arsimit, në cilësinë e koordinatorit;
 - Rrezart Veseli - Drejtor në ShFMU "Bajram Curri" në Krushë të Madhe, në cilësinë e trajnerit;
 - Gani Kryeziu - Mësimdhënës në ShML "Xhelal Hajda – Toni" në Rahovec, në cilësinë e trajnerit.
- Të lartpërmendurit në pikën 1 të këtij vendimi kanë të drejtë kompensimi për punën shtesë jashtë orarit të punës, për secilin prej tyre në shumën prej 560.00 (pesëqind e gjashtëdhjetë) euro, për periudhën kohore: 1.10.2025 deri më 31.12.2025, për punën jashtë orarit të rregullt gjatë ditëve të punës dhe gjatë fundjavës.
- Shuma e cekur në pikën 2 të këtij vendimi të paguhet në proporcion muaj për muaj, në bazë të raportit me nr. prot. 1140, të datës 10.3.2026.
- Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen Zyra e Personelit dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa në Komunën e Rahovecit.
- Vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Arsyetim

Duke u bazuar në punën e cila duhet të bëhet jashtë orarit të rregullt të punës dhe ditëve të fundjavës, të lartpërmendurit sipas pikës 1 të këtij vendimi, janë të obliguar që të mbajnë trajnime për zbatimin në praktikë të kurrikulës së re të Kosovës për mësimdhënësit e shkollave të komunës së Rahovecit, pasi të njëjtit janë të certifikuar në këtë drejtim.

Duke marrë parasysh se të lartpërmendurit janë detyruar që të punojnë jashtë orarit të rregullt të punës dhe ditëve të fundjavës për mbajtjen e trajnimeve, për shkak të angazhimit të mësimdhënësve në shkollat e komunës së Rahovecit, kanë të drejtë kompensimi jashtë orarit të punës.

Andaj, duke marrë parasysh se këta mësimdhënës të certifikuar janë të detyruar që të punojnë jashtë orarit të rregullt të punës dhe ditëve të fundjavës, kanë të drejtë kompensimi për punën shtesë jashtë orarit të punës sipas legjislacionit në fuqi.

Me vendim të njoftohen:

- *Të lartpërmendurit,*
- *Drejtoria për Arsim,*
- *Drejtoria për Buxhet dhe Financa,*
- *Njësia e Personelit, dhe*
- *Arkivi.*





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 7218 Nr. i faq/Br.str/No.pg 24
Data/Datum/Date 17 / 4 / 2026
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13, nenit 58 dhe nenit 62 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008”), nenit 74, nenit 85 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

1. Me të cilin **AUTORIZOHET** z. Afrim Oruqi, drejtor në Drejtorinë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, i lindur me datë 24.03.1982 në Rahovec, me vendbanim në Rahovec, Komuna e Rahovecit, me numër personal 11002485407, që t’i nënshkruaj të gjitha kontratat e punës të personelit shëndetësor të pranuar në bazë të konkurseve të shpallura nga Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale.
2. Autorizimi do të prodhoj efekte juridike deri në përfundimin e ushtrimit të detyrës sipas mandatit.
3. Vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Me vendim të njoftohen:

- Z. Afrim Oruqi,
- Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, dhe
- Arkivi.

